

Në trapjantimet e pranverës duhet të kushtohet kujdes që të mos ndodhë pjekja e parakohshme e bimëve, ose në të kundërt ngricat e vonuara mund të paraqesin rrezik të madh për bimët që sapo ambjentohen, të cilat janë në vegetacion të plotë dhe indet janë të ndjeshme ndaj ngricës.

Operacionet e trapjantimit zbatohen rregullisht duke pasur kujdes në përbërjen dhe përdorimin e materialit të plehut ku brenda së cilit zhvillohet sistemi rrenjor. Nëse plehu qëndron në kontakt me ambientin, duke u bërë i papërshkueshëm për ujin, ky efekt kërkon rregullimin e ujitjes për aparatit rrenjor të bimëve.

Para trapjantimit përgatitet terreni në raportet:

Pleh 50%

Rërë lumi 30 %

Torfë 20 %

Pleh 50%

Rërë lumi 30 %

Torfë 20 %

Bëhet pastrimi nga mbetjet, dizinfektimi me preparate kundër mikroorganizmave, kalbëzimit dhe shfaqjes së kërpudhave, bëhet përzierja e terrenit disa herë derisa të krijohet një masë homogjene me të gjithë përbësit e tij. Me pas bëhet mbjellja e bimëve në vazo ose qeska plastike (3-3.5 kg), në orët e para të mëngjezit, jo në mesditë dhe në ditë të nxehta.

Në trapjantimet e pranverës ujitja duhet të bëhet disa herë derisa terreni të jetë lagur plotësisht.



Vëmendja më e madhe duhet t'i kushtohet ujitjes duke u përshtatur me mjetet e nevojshme për të evituar dëmtimin e bimëve. Menjëherë pas mbjelljes bëhet sistemimi dhe ujitja me shoshë të imët me presion uji jo shumë të lartë.

Ujitja bëhet në orët e para të mëngjezit, ose kur rrezet e diellit nuk janë shumë të forta

Praktikat e kultivimit nuk ndryshojnë shumë nga ato të aplikuara në fushë.

Në disa raste, bimët pas trapjantimit në fushë për shkak të stresit frenojnë rritjen e bimës dhe e rimarrin veten pas pushimit dimëror.

Për të zgjidhur këtë problem në kohë të shkurtër bëhen trajtime duke përdorur hormonin giberilin (GA3) në dozën 50 - 200 mg/l.

Më pas bëhen trajtimet e duhura si me plehra, me preparate, pastrimi i sjetullorëve derisa fidani të ketë zhvillimin standart për të realizuar procesin e shartimit.

Shartimi realizohet në dy periudha; pranverë dhe vjeshtë. Ky operacion kërkon një kujdes dhe vëmendje të veçantë.



**QENDRA E TRANSFERIMIT TE
TEKNOLOGJIVE BUJQESORE
VLOREServis**

**TEKNIKA E AKLIMATIZIMIT
IN VIVO TE NENSHARTESAVE TE PEMEVE
FRUTORE**



**Kjo fletë palosje ju
ndihmon për tu njohur me
metodat e reja të
aklimatizimit te
neshartesave te pemëve
frutore bërthamore**

LUMTURI XHELILAJ

TEL 0694320403

Aplikimi i kulturës “in vitro” është një bioteknologji e re që konsiston në shumëzimin vegetativ të specieve të ndryshme të seleksionuara në kushte sterile.

Laboratori “in vitro”, realizon prodhimin e materialit bimor të çertifikuar të nënshartesave frutore, kryesisht pjeshk, kumbull, qersh, kajsi. Kjo teknik është aplikuar me sukses në prodhimin e kulturave “in vitro” të pastra nga ana fitopatogjene.

Rëndësi të madhe ka aklimatizimi i bimëve të prodhuara me metodën “in vitro”.

Para trapjantimit për në fidanishte, bimët “in vitro” duhet të kalojnë në periudhë të

Operacioni i trapjantimit gjatë ambjentimit

Bimët e rrënjëzuara “in vitro”, me karakteristikat e fituara i nënshtrohen transferimit për në Serrë e aklimatizimit. Serra duhet të dizinfektohet dhe hapet pas 24 orëve. Para ambjentimit të bimëve puna fillon me përgatitjen e materialit për trapjantim: Materialet që do të përdoren për ambjentim duhen të gjitha sterile

Fazat e ambjentimit

Zgjatja e aklimatizimit të pemëve frutore konsiston në raportin stinë dhe specie.

Periudha më e përshtatshme për ambjentimin e pemëve frutore është në fund të dimrit dhe fillimi i pranverës në marrjen e vlerave optimale të temperaturave.

Bimët karakterizohen nga një zhvillim i madh i kërcenjve, gjethëve që rritin aktivitetin fotosintetik si dhe zhvillim të sistemit rrënjor.



Aklimatizimi i pemëve frutore bërthamore bëhet në një afat kohor 50-60 ditë në fund të dimrit dhe 30-45 ditë në pranverë. Nuk mund të ambjentohen bimët në muajin Nëntor. Dhjetor. Në bimë frenohet rritja dhe në qafën e rrënjës fillojnë të shfaqen kërpudhat e kalbëzimi i qafës së saj.

Nuk rekomandohet të ambjentohet, kur bimës i mungon ngrohja bazale dhe drita e nevojshme për rritje dhe zhvillim.

Ambjentimi kalon 4 momente:

1. Qëndrimi në bankale:



1-2 rrjeta të errëta mbi mbulesën plastike (me thurje 50% hyrje drite). Kjo periudhë zgjat 30 - 45 ditë

2. Faza ndërmjetëse:

Në këtë fazë fillon kufizimi i lagështirës duke ngritur gradualisht nga 8-10 cm mbulesën plastike bankale vetëm në një krah pasi hapja në të dy krahët i vyshk bimët. Ky kalim zgjat 5-7 ditë.

3. Zhvillimi në serrë:

Eshtë periudha e rritjes së bimës në përmasa të nevojshme mbi 20 cm lartësi.

Kjo fazë zgjat 3 - 4 javë në varësi të temperaturave të ambjentit dhe të rritjes dhe zhvillimit të bimës.

Ambjenti ku do të sistemohen bimët duhet sa më i freskët, trapjantimi bëhet në orët e para të mëngjesit.

Mbjellja bëhet në vazo të reja ose në rast se janë të përdorura lahen dhe dizinfektohen me Previcur ose Propland

4. Transferimi në ambjente Hijezimi (Ombratio)

Pas ambjentimit bimët transferohen në ombratio. Trapjantimet realizohen në periudhën e pranverës ku paraqesin shumë më pak probleme, në krahasim me ato që bëhen gjatë periudhës së verës, në veçanti në muajt Qershor, Korrik dhe Gusht, sepse bimët pësojnë stres hidrik dhe frenojnë rritjen dhe zhvillimin normal të tyre. Në disa raste bimët rizgjohen vetëm në vitin pasardhës

Kur bimët trapjantohen për në serrë në fund të pranverës qëndrojnë një muaj dhe transferohen në ambjente Hijezimi.

Nëse do të ambjentojmë bimë në periudhën e vjeshtës bimët pas trapjantimit qëndrojnë në Serrë gjatë gjithë dimrit deri në pranverën e vitit pasardhës.

